

KËSHILLI I KOMUNËS SË KËRÇOVËS

Nr. 08-1165/2

12.03.2026

K ë r ç o v ë

PROCESVERBAL

Nga seanca e 7-të e rregullt e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 12.03.2026 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 13:00.

Seancën në ora 13:00 e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Ajhan Sulkoski, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Zhaneta Milanoska Petreska, Aleksandar Mickoski, Mihajlo Daniloski, Irena Naumoska, Violeta Stefanoska, Bojan Trajkoski, Dragan Dejanoski, Mirsad Ramazanovski, Ilir Rushani, Shefki Imeti, Siarta Saliju Osmani, Asip Zendeli, Fadil Emmini, Teuta Ahmedi Purellku dhe Kujtim Kasami, Beqir Osmani dhe Stevo Stefanoski dhe Latife Imani.

Në seancë ishin të pranishëm edhe: Sekretarja e komunës – Aneta Nasteska, Valdet Selimi, Burim Kadriu, Riste Lazarovski, Darko Belevski, Lençe Srbinoska, Mite Dimitrijoski, Arben Ristemi— përfaqësues nga administrata komunale, Drejtori i IK Universiteti i Punëtorëve "Krstë Misirkov" Kërçovë, Drejtori i IPK Kopshti i fëmijëve "Olga Miceska" Kërçovë, Drejtori dhe përfaqësuesi i NPK "Komunalec", përfaqësues dhe drejtorë nga SHMK "Mirko Mileski" Kërçovë, SHMK "Drita" Kërçovë, SHF "Sande Shterjoski" Kërçovë, SHF "Dr. Vladimir Polezhinoski", SHF "Faik Konica" Greshnicë, SHF "Rexhë Rushit Zajazi" Zajas, SHF "Milto Gurra" Strellcë, SHF "Naim Frashëri" Jagoll Dollencë, SHF "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu" Sërbicë, SHF "Hristo Uzunov" Drugovë.

Në mbledhje mori pjesë edhe gazetari nga: TV Uskana dhe TV Gurra.

Kryesuesi i këshillit, pasi konstatoi se ka kuorum për punë, pyeti nëse dikush ka vërejtje mbi Procesverbalin e mbledhjes së 6-të të Këshillit të Komunës së Kërçovës, të mbajtur më datë 16.02.2026.

Syarta Saliu Osmani - informon se është kundër procesverbalit, pasi i njehti nuk e pasqyrore qëndrimin e saj. Ajo theksoi se kjo nuk ishte hera e parë dhe do të jetë hera e fundit që ndodh kjo nga momenti kur nuk thuhet ajo që është. Theksoi se do të ndërmarrë gjithçka që është e nevojshme dhe se duhet të respektohet fjalimi i saj dhe fjala e tyre, si të zgjedhur nga populli.

Kryesuesi i Këshillit e vendosi në miratim Procesverbalin e seancës së 6-të të Këshillit të mbajtur më datë 16.02.2026 dhe i njëjti u miratua me 14 vota PËR. 5 vota KUNDËR . TË PËRMBAJTUR (nuk ka).

Kryetari i Këshillit, për këtë seancë propozoi rendin e ditës si vijojn:

R E N D I I D I T Ë S

1. Propozim Vendim për zgjerimin e mjeteve në Buxhetin e Komunës së Kërçovës për vitin 2026.
2. Raport për shfrytëzimin e rezervave nga Buxheti i Komunës së Kërçovës.
3. Miratimi i Raportit financiar për punën e Komunës së Kërçovës për vitin 2025
4. Miratimi i Llogarisë përfundimtare të Komunës së Kërçovës për vitin 2025.
5. Miratimi i Raportit financiar për punën e NP"Komunalec" për vitin 2025
6. Miratimi i Llogarisë përfundimtare të NP"Komunalec" Kërçovë për vitin 2025.
7. Miratimi i Llogarisë përfundimtare për vitin 2025 të SHMK "Mirko Mileski" Kërçovë.
8. Miratimi i Llogarisë përfundimtare për vitin 2025 të SHMK "Drita" Kërçovë.
9. Miratimi i Llogarisë përfundimtare për vitin 2025 të SHF "Sande Shterjoski" Kërçovë.
10. Miratimi i Llogarisë përfundimtare për vitin 2025 të SHF "Vlladimir Polezhinoski" Kërçovë.
11. Miratimi i Llogarisë përfundimtare për vitin 2025 të SHF "Faik Konica" Greshnicë.
12. Miratimi i Llogarisë përfundimtare për vitin 2025 të SHF "Rexh Rushit Zajazi" Zajaz.
13. Miratimi i Llogarisë përfundimtare për vitin 2025 të SHF "Milto Gurra" Strellcë.
14. Miratimi i Llogarisë përfundimtare për vitin 2025 të SHF "Naim Frashëri" Jagoll Dolencë.

- 15.Miratimi i Llogarisë përfundimtare për vitin 2025 të SHF “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” Sërbicë.
- 16.Miratimi i Llogarisë përfundimtare për vitin 2025 të SHF “Hristo Uzunov” Dërgovë.
- 17.Miratimi i Llogarisë përfundimtare për vitin 2025 të IPK Çerdhja e fëmijëve “Ollga Miceska” Kërçovë.
- 18.Miratimi i Llogarisë përfundimtare për vitin 2025 të IK Universiteti i punëtorve “Krste Misirkov Kërçovë.
- 19.Konkluzion për miratim e Raportit të Programit për punën e IK Universiteti i Punëtorëve „Krste Misirkov” Kërçovë për vitin 2025
20. Miratimi i Llogarisë përfundimtare për vitin 2025 të SHF “Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë.
- 21.Miratimi i Raportit për regjistrim për vitin 2025 në Komunën e Kërçovës.
- 22.Propozim Vendim për pjesmarrje vetanake/kofinancim për Projekt – Ndërtimi i rezervuarit për ujë të pishëm 70cm³ në fsh.Novo Sello.
- 23.Propozim Statut i Ndërmarrjes Publike “Kërçova Proekt”.
- 24.Propozim Vendim për marrjen e borxhit të SHMK”Mirko Mileski”Kërçovë.
- 25.Propozim Program për vendosjen e Paisjes Urbane në Komunën e Kërçovës.
- 26.Propozim Rregullore për punë të trupit participativ.
- 27.Propozim Vendim për miratimin e VENDIMIT për lidhjen e Marrëveshjes me klauzolë të dokumentit përmbarues ndërmjet NP “Komunalec” – Kërçovë, NP “Studençica” – Kërçovë dhe Komunës së Kërçovës
- 28.Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit të VENDIMIT STATUTAR për ndryshimin e Statutit të NP “Komunalec”- Kërçovë
- 29.Propozim Vendim për emrimin e antarit në Këshillin drejtues në IPK ÇF”Ollga Miceska” Kërçovë.

Kryetari i këshillit pyeti nëse dikush plotësim ndryshim të Rendit të ditës.

Valdet Selimi informoi se ka plotësim të rendit të ditës me një pikë, e cila do të jetë pika e 30-të: Vendim për kotizim.

Kryetari i këshillit e vendosi në miratim Rendin e ditës me një plotësim të propozuar dhe i njejt i miratua me 19 vota PËR, KUNDËR (asnjë) dhe PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit- duke qenë se përfaqësuesi për pikën e 22-të të rendit të ditës duhej të udhëtonte, informoi se kjo pikë do të shqyrtohet e para.

22.PIKA E NJËZETEDYTË: Propozim Vendim për pjesëmarrje vetiake/bashkëfinancim për Projektin-Ndërtimi i rezervuarëve për ujë të pijshëm 70m³ në fshatin Novo Sellë.

Darko Beleski informoi se komuna aplikon në shpallje të tilla të ndryshme dhe tani janë në vijim shpallje të tilla publike për projekte nga Qeveria dhe Ministrinë, dhe është aplikuar për dy rezervuarë, edhe atë për në Ivançishtë dhe në Novo Sellë. Ai theksoi se kishin 5 milionë denarë dhe tani komuna dëshironte të merrte pjesë me bashkëfinancim në këtë Projekt me 477 mijë denarë dhe për këtë ishte e nevojshme të merret Vendim nga këshilli.

Kryetari i këshillit e vendosi në miratim Propozim Vendimin për pjesëmarrje vetiake/bashkëfinancim për Projektin-Ndërtimi i rezervuarëve për ujë të pijshëm 70m³ në fshatin Novo Sellë dhe ai u miratua me 17 vota PËR, KUNDËR (asnjë) dhe 2 vota PËRMBAJTUR.

1.PIKA E PARË: Propozim Vendim për zgjerimin e mjeteve në Buxhetin e Komunës së Kërçovës për vitin 2026.

Mihajlo Danilloski - e lexoi Raportin nga mbledhja e mbajtur e Komisionit për financa dhe buxhet dhe informoi se kjo pikë u miratua njëzëri nga të gjithë të pranishmit.

Burim Kadriu - informoi se kjo pikë ishte për zgjerimin e mjeteve në buxhet dhe kjo ishte me kërkesë të SHMK "Mirko Mileski" të cilët kishin kontributet e tyre, por nuk ishin parashikuar në buxhet. Bëhej fjalë për 300.000 denarë. Theksoi se në Vendim kishte edhe një gabim teknik që duhet të përmirësohet, në vend të arsimit fillor, duhet të qëndrojë arsimit i mesëm.

Kryetari i këshillit e vendosi në miratim Propozim Vendimin për zgjerimin e mjeteve në Buxhetin e Komunës së Kërçovës për vitin 2026 dhe ai u miratua me 19 vota PËR, KUNDËR (asnjë) dhe PËRMBAJTUR (asnjë).

2.PIKA E DYTË: Raport për shfrytëzimin e rezervave nga Buxheti i Komunës së Kërçovës.

Mihajlo Danilloski- informoi se edhe tre pikat e tjera që janë në kompetencë të komisionit u shqyrtuan në mbledhjen e Komisionit për Financa dhe buxhet dhe u miratuan njëzëri.

Burim Kadriu- informoi se kjo pikë ishte për shfrytëzimin e rezervave buxhetore. Me Vendim të këshillit kishte mjete të aprovuara për ndihmë të të dëmtuarve nga zjarri vitin e kaluar në Koçan dhe ato i janë paguar Kryqit të Kuq, e prej andej familjeve të të dëmtuarve.

Stevo Stefanoski- informoi se ai Vendim ishte sjellë nga përbërja e kaluar e këshillit dhe pyeti pse tani po flitej për të. Mjetet ishin transferuar më 30.05.2025 dhe nuk e kishte të qartë pse tani ndodh kjo.

Burim Kadriu- informoi se për shfrytëzimin e rezervave buxhetore duhet të informohet këshilli. Pas përfundimit të vitit sillet Raport për shfrytëzimin e tyre. Në vitin 2025 ishte sjellë Vendimi dhe ato ishin shfrytëzuar më 30.05.2025 përmes Kryqit të Kuq.

Stevo Stefanoski: "Në rregull".

Kryetari i këshillit e vendosi në miratim Raportin për shfrytëzimin e rezervave nga Buxheti i Komunës së Kërçovës dhe i njëjti u miratua me 19 vota PËR, KUNDËR (asnjë) dhe PËRMBAJTUR (asnjë).

Përfaqësuesi i arsyetoi pikën e tretë dhe të katërt së bashku.

3.PIKA E TRETË: Miratimi i Raportit financiar për punën e Komunës së Kërçovës për vitin 2026 dhe

4.PIKA E KATËRT: Miratimi i Llogarisë përfundimtare të Komunës së Kërçovës për vitin 2025.

Burim Kadriu informoi se pikën e tretë dhe të katërt do t'i arsyetojë së bashku. Informoi se në Raportin Financiar janë paraqitur kompetencat e komunës, buxheti, rebalansi, të hyrat, burimet e financimit etj. Theksoi se të hyrat kishin realizim për vitin 2025 rreth 86% dhe dha arsyetim të detajuar për këtë. Pastaj, informoi se shpenzimet kanë realizim prej 65% dhe i arsyetoi sipas programeve. Informoi edhe për llogaritë e reja të hapura të komunës, bilancin e gjendjes së organit dhe për obligimet e komunës të cilat ishin 55 milionë denarë.

Kryetari i Këshillit i vendosi së bashku për miratim Raportin financiar për punën e Komunës së Kërçovës për vitin 2026 dhe Llogarinë përfundimtare të Komunës së Kërçovës për vitin 2025, të cilat u miratuan me 17 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 2 vota PËRMBAJTUR.

5.PIKA E PESTË: Miratimi i Raportit financiar për punën e NP "Komunalec" Kërçovë për vitin 2025.

Përfaqësuesi i NP "Komunalec": Informoi se Raportin financiar dhe llogarinë përfundimtare do t'i shqyrtojë së bashku, pasi ishin të njëjta. Theksoi se për vitin 2025 janë realizuar të hyra prej 190 milionë denarë dhe dha shpjegime për to. Rezultati financiar ishte negativ me 13 milionë denarë. Shpenzimet ishin në vlerë prej 53 milionë denarë dhe i arsyetoi ato.

Illir Rushani: Pyeti pse rezultati financiar është negativ dhe nëse kjo ka ndodhur për shkak të menaxhimit të dobët me ndërmarrjen.

Përfaqësuesi i NP "Komunalec": Informoi se ai është Udhëheqës i Sektorit për Financa dhe ishte aty për Raportin financiar dhe Llogarinë përfundimtare, andaj nuk ishte i autorizuar t'i përgjigjej asaj pyetjeje.

Illir Rushani: Kërkoj që të vijë Drejtori i ndërmarrjes për t'u përgjigjur dhe për të shpjeguar.

Kryetari i Këshillit e vendosi në miratim Raportin financiar për punën e NP "Komunalec" Kërçovë për vitin 2025 dhe i njëjti u miratua me 11 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 7 vota PËRMBAJTUR.

Këshilltari Mihajlo Daniloski u lirua nga votimi, pasi është i punësuar në ndërmarrje.

Pastaj, Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim edhe PIKËN E GJASHTË të rendit të ditës: Miratimi i Llogarisë përfundimtare të NP "Komunalec" Kërçovë për vitin 2025 dhe e njëjta u miratua me 11 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 7 vota PËRMBAJTUR.

Këshilltari Mihajlo Daniloski u lirua nga votimi, pasi është i punësuar në ndërmarrje.

7.PIKA E SHTATË: Miratimi i Llogarisë përfundimtare për vitin 2025 të SHMK "Mirko Mileski" Kërçovë.

Mihajlo Daniloski: Kërkoj që llogaritë përfundimtare të të gjitha shkollave të votohen së bashku në paketë.

Kryetari i Këshillit e vendosi në votim propozimin e Mihajllos dhe i njëjti u miratua me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMABJTUR (asnjë).

Pastaj, Kryetari i Këshillit i vendosi për miratim Llogaritë përfundimtare të të gjitha shkollave nga pika e 7-të deri te pika e 16-të dhe pika e 20-të e Rendit të ditës, dhe ato u miratuan me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kalohet në:

17.PIKA E SHTATËMBËDHJETË: Miratimi i Llogarisë përfundimtare për vitin 2025 të IPK Kopshti i fëmijëve "Olga Miceska" Kërçovë.

Drejtori i IPK Kopshti i fëmijëve "Olga Miceska" Kërçovë: Informoi se kopshti ka 3 llogari dhe i arsyetoi të gjitha në detaje.

Kryetari i Këshillit e hodhi për miratim Llogarinë përfundimtare për vitin 2025 të IPK Kopshti i fëmijëve "Olga Miceska" Kërçovë dhe e njëjta u miratua me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Drejtori i IK Universiteti i Punëtorëve "Krste Misirkov" Kërçovë i arsyetoi së bashku:

18.PIKA E TETËMBËDHJETË: Miratimi i Llogarisë përfundimtare për vitin 2025 të IK Universiteti i Punëtorëve "Krste Misirkov" Kërçovë dhe

19.PIKA E NËNTËMBËDHJETË: Konkluzion për miratimin e Raportit të Programit të punës të IK Universiteti i Punëtorëve "Krste Misirkov" Kërçovë.

Drejtori i IK Universiteti i Punëtorëve "Krste Misirkov" Kërçovë: Informoi se kanë 4 llogari dhe i arsyetoi secilën veç e veç. Pastaj, në detaje e arsyetoi edhe Raportin e Programit të punës të IK Universiteti i Punëtorëve "Krste Misirkov" Kërçovë.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Llogarinë përfundimtare për vitin 2025 të IK Universiteti i Punëtorëve "Krste Misirkov" Kërçovë dhe e njëjta u miratua me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Pastaj, Kryetari i këshillit e vendosi në miratim Raportin e Programit të punës të IK Universiteti i Punëtorëve "Krste Misirkov" Kërçovë dhe ai u miratua me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Duke qenë se pika e 20-të e rendit të ditës ishte miratuar paraprakisht, u kalua në:

21.PIKA E NJËZETE E NJË: Miratimi i Raportit për regjistrim për vitin 2025 në Komunën e Kërçovës

Lençe Srbinoska - Informoi se Komisioni i regjistrimit prej nëntë anëtarësh i formuar nga Kryetari i Komunës kishte punuar në mënyrë aktive. Ajo theksoi se cilat ndërtesa administrative dhe hapësira ishin regjistruar dhe se regjistrimi ishte i datës 31.12.2025. U regjistruan mjetet bazë, mjetet monetare në arkë, mjetet monetare në llogaritë me të cilat punon komuna si dhe kërkesat dhe detyrimet e komunës. Pastaj, dha shpjegime për to. Theksoi se pjesë përbërëse e Raportit janë edhe listat e regjistrimit të cilat gjenden në arkivin e komunës.

Kryetari i këshillit e vendosi në miratim Raportin për regjistrim për vitin 2025 në Komunën e Kërçovës dhe ai u miratua me 17 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 2 vota PËRMBAJTUR.

Duke qenë se pika e 22-të e rendit të ditës ishte shqyrtuar dhe miratuar në fillim të seancës, u kalua në:

23.PIKA E NJËZET E TRE: Propozim Statut i Ndërmarrjes Publike “Kërçova Proekt”.

Aneta Nasteska - Informoi se statuti është përgatitur në përputhje me emrin dhe veprimtarinë e ndërmarrjes. Informoi se te anëtarët e Bordit drejtues, në vend të 5 duhet të qëndronte 3 anëtarë. Theksoi se Statuti është përgatitur në përputhje me rregullat ligjore.

Illir Rushani - Informoi se në nenin 6 dhe nenin 7 në Statut, te vula dhe vula e rrumbullakët, përveç në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik, duhet të jetë edhe në gjuhën shqipe dhe alfabetin latin e shkruar selia e ndërmarrjes, që të përdoret gjuha edhe e kombësive. Theksoi se në nenin 32 duhet të qëndronte se kompensimin për Bordin drejtues duhet ta përcaktojë themeluesi, e jo Bordi drejtues, siç qëndronte, sepse në atë rast do të kishte konflikt interesi.

Aneta Nasteska - Kërkoj falje për gabimet dhe theksoi se ato do të përmirësohen dhe se pranohet propozimi për nenin 32.

Syarta Saliju Osmani - Informoi se Statuti është diskriminues, në nenin 5 te vetë emërtimi i ndërmarrjes duhej të ishte sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve, ndërsa edhe në nenin 7 dhe 8 nuk ishin përdorur plotësisht siç duhet. Theksoi se Statuti

ishite ambalazh i mirë dhe se është rrezik për të ardhmen. Në nenin 21 kërkohet të emërohet një person i cili duhet të ishte shtetas i R.M., por pasi emri ka ndryshuar, duhet të qëndronte Maqedonia e Veriut, e jo R.M. Nuk respektohet ligjshmëria në Statut dhe propozoi që në të gjitha nenet të korrigohej emri.

Aneta Nasteska - Informoi se Statuti nuk është miratuar.

Syarta Saliju Osmani - Informoi se ai po propozohet me emër që nuk është në përdorim.

Aneta Nasteska - Informoi se nëse kishte diçka që duhet të ndryshohej, do të ndryshohet.

Syarta Saliju Osmani - Informoi se nuk duhet të tolerohen ato gabime, pasi bëhet fjalë për Statut.

Kryetari i këshillit e vendosi në miratim Propozim Statut i Ndërmarrjes Publike “Kërçova Proekt” me të gjitha ndryshimet e propozuara dhe ai u miratua me 16 vota PËR, 3 vota KUNDËR. PËRMBAJTUR (asnjë).

24.PIKA E NJËZET E KATËRT: Propozim Vendim për marrjen e borxhit të SHMK”Mirko Mileski”Kërçovë.

Aneta Nasteska - Informoi se bëhet fjalë për një projekt i cili është në fazën përfundimtare për kyçje në rrjetin elektrik. Ai duhet të paguhej me dhjetë këste dhe komuna pranon ta marrë përsipër borxhin.

Kryetari i këshillit e vendosi në miratim Propozim Vendimin për marrjen e borxhit të SHMK "Mirko Mileski" Kërçovë dhe i njëjti u miratua me 15 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 4 vota PËRMBAJTUR.

25.PIKA E NJËZET E PESTË: Propozim Program për vendosjen e pajisjeve urbane në Komunën e Kërçovës

Riste Lazarevski - Informoi se bëhet fjalë për Program urban për vitin 2026 dhe se një Program i tillë sillet çdo vit. Theksoi se Programi ka 4 pjesë të cilat janë të ndara sipas pozicioneve. Që të lëshohet Aktvendim për vendosjen e pajisjeve urbane, ai program fillimisht duhet të miratohej nga ana e këshillit.

Fadil Emini – Kërkoj një ndryshim të programit, pasi në program ishin përfshirë vetëm lokacione nga pjesa urbane e qytetit; kërkoj që të përfshihen edhe mjediset

rurale, konkretisht të parashihen shkollat fillore në fshatin Cërivicë dhe fshatin Tuhin, pasi kishte kushte për këtë.

Riste Lazarevski – Pyeti nëse kërkon kënd lojërash apo vendosjen e stolave dhe rekuizitave të tjera.

Fadil Emini – Informoi se kërkon vendosjen e stolave për pushim, shportave për mbeturina dhe rekuizitave të tjera.

Riste Lazarevski – Informoi se ajo pjesë nuk ishte e shteruar dhe se mund të vendoseshin edhe jashtë asaj.

Fadil Emini – „Do të shohim nëse do të vendosen“.

Teuta Ahmedi Parelku – Propozoi që këtu të përfshihet edhe gjimnazi dhe që hapësira para tij të pastrohet, duke theksuar se kjo do të ishte mirë për të gjithë.

Riste Lazarevski – Informoi se po përgatitet një Program i ri i veçantë për atje dhe se metë do të përfshihet dhe rregullohet hapësira para gjimnazit.

Teuta Ahmedi Parelku – Pyeti nëse do të mund të rregullohej një kënd, mini-amfiteatër me stola etj.

Riste Lazarevski – „Mundet“.

Stevo Stefanoski – Informoi se kishte parë që në lagjen „Karposh“, nga ndërtesa e vjetër e ish komunës deri te rruga rajonale, nuk kishte të vendosur pajisje urbane dhe propozoi që, nëse është e mundur, aty të vendosen stola, rekuizita për fëmijë etj.

Riste Lazarevski – Informoi se kishte një pozicion të paraparë me: stola, lulishte (zhardiniera) etj.

Stevo Stefanoski – „Në rregull“.

Kryetari i këshillit e vendosi në votim Propozim-Programin për vendosjen e Pajisjeve Urbane në Komunën e Kërçovës dhe ai u miratua me 12 vota PËR, 7 vota KUNDËR dhe asnjë PËRMBAJTUR.

26.PIKA E NJËZETË E GJASHTË: Propozim Rregullore për punë të trupit participativ.

Riste Lazarevski – Informoi se sipas Ligjit ishte paraparë që, përveç komisionit, të ketë edhe një Trup Pjesëmarrës për urbanizëm. Theksoi se në vitin 2022 ishte bërë një përpjekje për formimin e tij, por askush nuk ishte paraqitur në shpallje. Informoi se në atë trup mund të anëtarësoheshin komisioni nga kryetari i komunës, persona profesionistë të urbanizmit, persona profesionistë të planifikimit, përfaqësues nga çdo Bashkësi Lokale, si dhe mund të paraqiteshin anëtarë të këshillit. Trupi kishte rol konsultativ të rregulluar me nenin 46 të Ligjit.

Kryetari i këshillit e vendosi në miratim Propozim Rregullorë për punë të trupit participativ dhe ajo u miratua me 17 vota PËR, asnjë KUNDËR dhe 2 vota PËRMBAJTUR.

27. PIKA E NJËZETË E SHTATË: Propozim Vendim për miratimin e VENDIMIT për lidhjen e Marrëveshjes me klauzolë të dokumentit përmbarues ndërmjet NP “Komunalec” – Kërçovë, NP “Studëncica” – Kërçovë dhe Komunës së Kërçovës

Kryetari i këshillit – Informoi se për këtë pikë kishin marrë materiale dhe se përfaqësuesi nuk është i pranishëm për arsye shëndetësore për ta arsyetuar atë.

Shefki Imeti – Informoi se nëse ai nuk ka mundur të vijë, atëherë duhej të vinte dikush tjetër i autorizuar për ta mbrojtur atë pikë, në të kundërt propozoi që pika të kalojë në një seancë tjetër.

Ilir Rushani – Informoi se përfaqësues për këtë pikë duhej të ishte Drejtori dhe ai duhej të ishte këtu. Kërkoj që pika të tërhiqet nga rendi i ditës.

Syarta Saliju Osmani – Informoi se i mbështet kolegët dhe nëse kjo pikë do të miratohej, këshilltarët nga grupi i tyre do ta lëshonin seancën në shenjë demonstrative.

Kryetari i këshillit dha pauzë prej 5 minutash.

Pas pauzës seanca vazhdoi.

Drejtori i NPK „Komunalec“ – Informoi se marrëveshja kishte kaluar në Bordin Drejtues dhe Mbikëqyrës dhe se Marrëveshja ishte e nevojshme për t’u çliruar nga borxhet. Kishte një Aktgjykim nga gjykata. Nuk mund të paguhej asgjë nëse nuk miratohej ajo marrëveshje. Theksoi se kjo duhej të bëhej patjetër, në mënyrë që të shlyhej borxhi i cili ishte 123 milionë denarë.

Shefki Imeti – Informoi se ndërmarrja është me 50 të punësuar dhe ishte parazite dhe tani ishte e nevojshme që këshilli ta miratojë këtë, që komuna të mund ta paguajë borxhin. Pyeti se prej nga do të paguhet kjo dhe a do të paguhet borxh parazit. Obligim i qytetarëve ishte të paguajnë për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujësjellësit. Theksoi se me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje do të ketë pagesë të njëanshme. Theksoi se kjo është politikë dhe se nuk duhej të punësoheshin aktivistë. Për këtë, duhej të gjendej zgjidhje, sepse me këtë do të rriteshin shpenzimet e qytetarëve. Informoi se ai është kundër kësaj.

Drejtori i NPK „Komunalec“ – Informoi se ai borxh ishte trashëguar nga 14 vitet e fundit. Marrëveshja e fundit ishte nga viti 2014. Theksoi se duhej të bëhej Marrëveshje për pagesë me këste.

Ilir Rushani – Pyeti për vitin 2014 se cili borxh nuk është paguar atëherë.

Drejtori i NPK „Komunalec“ – Informoi se nuk janë paguar këstet atëherë, nuk është respektuar Marrëveshja dhe për këtë arsye ishte shkëputur.

Syarta Saliju Osmani – Informoi se „Studençica“ është ajo që kërkon, ndërsa ai që detyrohet është „Komunalec“. Ajo theksoi se nuk kishte transparencë ndaj tyre dhe qytetarëve, sepse në Marrëveshje nuk kishte informacion për shumën.

Drejtori i NPK „Komunalec“ – Informoi se për këtë kishte procesverbal i cili u ishte dorëzuar.

Shefki Imeti – Informoi se për shkak të transparencës duhej të thuhej se borxhi ishte nga viti 2013 dhe se Kërçova nuk duhej të paguante për të tjerët, por vetëm për vete, e jo për Dollnenin etj.

Kryetari i këshillit e vendosi në miratim Propozim Vendim për miratimin e VENDIMIT për lidhjen e Marrëveshjes me klauzolë të dokumentit përmbarues ndërmjet NP “Komunalec” – Kërçovë, NP “Studençica” – Kërçovë dhe Komunës së Kërçovës dhe i njehti u miratua me 11 vota PËR, 7 vota KUNDËR dhe asnjë PËRMBAJTUR.

Këshilltari Mihajlo Daniloski u lirua nga votimi, pasi është i punësuar në NPK „Komunalec“.

28.PIKA E NJËZETË E TETË: Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit të VENDIMIT STATUTAR për ndryshimin e Statutit të NP “Komunalec”- Kërçovë

Drejtori i NPK „Komunalec“ – Informoi se bëhet fjalë për marrjen e kompetencave për grumbullimin e qenve endacakë dhe për transportin, dhe nga kjo të çlirohet komuna.

Syarta Saliju Osmani – Informoi se këtu bëhet fjalë për ndryshimin dhe plotësimin e veprimtarisë së ndërmarrjes dhe pyeti se për cilat relacione parashihet transporti i udhëtarëve.

Drejtori i NPK „Komunalec“ – Për Komunën e Kërçovës.

Syarta Saliju Osmani – Informoi se nuk e ka të qartë nëse do të transportohen nxënësit ose cilat kategori të tjera të udhëtarëve.

Drejtori i NPK „Komunalec“ – Informoi se do të transportohen nxënësit.

Shefki Imeti – Informoi se me faktin që ndërmarrja do të transportojë nxënës, do të mbyllet sektori privat.

Drejtori i NPK „Komunalec“ – Informoi se ajo ndërmarrje ishte me interes publik.

Kryetari i këshillit e vendosi në miratim Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit të VENDIMT STATUTAR për ndryshimin e Statutit të NP “Komunalec”- Kërçovë dhe i njejtë u miratua me 11 vota PËR, 7 vota KUNDËR dhe asnjë PËRMBAJTUR.

Këshilltari Mihajlo Daniloski u lirua nga votimi, pasi është i punësuar në ndërmarrje.

29.PIKA E NJËZETË E NËNTË: Propozim Vendim për emrimin e antarit në Këshillin drejtues në IPK ÇF”Ollga Miceska” Kërçovë.

Valdet Selimi – Informoi se Vendimi u është dorëzuar në materiale dhe e arsyetoi atë. Propozoi që të miratohet.

Kryetari i këshillit e vendosi në miratim Propozim Vendim për emrimin e antarit në Këshillin drejtues në IPK ÇF”Ollga Miceska” Kërçovë dhe ai u miratua me 12 vota PËR, 4 vota KUNDËR dhe 2 vota PËRMBAJTUR.

30.PIKA E TRIDHJETË: Vendim për kotizimin

Valdet Selimi – Informoi se ka një kërkesë nga Klubi i Hendbollit Kërçovë që t'i paguhet kotizimi.

Ilir Rushani – Informoi se me atë Vendim nuk respektohej parimi i barazisë. Theksoi se për shembull Klubi i Futbollit për femra „Uskana“ është në rang më të lartë se Klubi i Hendbollit, por për të nuk paguhej kotizim. Theksoi se për këtë duhet t'u thuhet qytetarëve, këtu kishte diskriminim dhe propozoi që të përfshihen edhe të tjerët me kotizimin. Informoi se nuk është kundër.

Valdet Selimi – Informoi se kjo është sipas kërkesës së dorëzuar nga Klubi i Hendbollit dhe se klubet e tjera nuk kishin dorëzuar kërkesa të tilla.

Syarta Saliju Osmani – Propozoi që të ftohen të gjitha klubet të dorëzojnë kërkesë dhe se ishte mirë që tani këtë po e ndiqnin edhe mediat e pranishme në seancë.

Përshkak se askush tjetër nuk e morri fjalën, dhe me këtë u shterë rendi i ditës për këtë seancë, ndërsa Kryetari i këshillit e mbylli seancën në ora 15 e 05.

Procesverbalist

-Lençe Srbinoska

Përkthyes:Tefik Asani

Këshilli i Komunës së Kërçovës
Kryetar
Ajhan Sulkovski